



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 51/16

Prishtinë, më 30.03.2016, ora 12:15

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Ilir Deda, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Pjesëmarrës të ftuar: Ismet Kransiqi - Sekretar i Kuvendit, Emrush Haxhiu – Drejtor i Përgjithshëm i Administratës dhe Istet Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Pagesa.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitet 2017-2019;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitet 2017-2019

Safete Hadergjonaj – njoftoi se grupi punues, ka mbajtur një takim me administratën e Kuvendit ku është shqyrtuar drafti i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit 2017-2019, i përgaditur nga administrata. Nga ajo që është prezantuar, kemi bërë ndryshim në projektin kapitale “Qendra Protokolare, në Blinajë”, ku janë shtuar 1 milion euro në vitin 2017 dhe 2 milion euro në vitin 2018. Ndryshim tjetër, ka të bëjë me numrin e të punësuarve që ka të bëjë me zbatimin e MSA-së, dhe janë shtuar 10 të punësuar në vitin 2017, dhe 10 të tjerë në vitin 2018.

Naser Osmani – u interesua lidhur me projektin e qendresë protokolare në Blinajë, për të cilin ekziston projekti i hartuar nga Ministria e Administratës Publike. Po ashtu pyeti sa a është përlogaritur kostoja e zbatimit të ligjit për deputetë?

Fikrim Damka – pyeti pse janë paraparë mjete buxhetore për dreka zyrtare për grupet parlamentare, kur këto mjete mbulohen nga fondi për financimin e partive politike?

Ismet Kransiqi – sqaroi se projekti i qendresë protokolare në Blinajë është hartuar nga MAP, dhe parashihet që të realizohet me participim. Sa i përket kostos së ligjit për deputetët, ajo nuk është bërë, pasi që është menduar që të rregullohet me Ligjin për Kuvendin. Në lidhje me pyetjen e z. Damka, sqaroi se kryetari i grupit parlamentar, ka të lejuar një shumë prej 80 euro për reprezentacion për kafe dhe pije që bëhen gjatë punës, brenda Kuvendit.

Pas sqarimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit, të miratojë Kornizën Afatmesme e Shpenzimeve e Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017-2019, dhe të kërkohet nga Ministria e Financave, që e njëjta të përfshihet në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2017-2019.

Mbledhja përfundoi në ora 12:37

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani